



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1574/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me zyrtarin ligjor, Fatlum Gashi në konfliktin administrativ të paditësit, IPKO Telecommunications LLC nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson, Isamedin Dedinca avokat nga Prishtina, kundër të paditurit, Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson, Visar Bibaj zyrtar ligjor i të paditurit, për shkak të anulimit të vendimit, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarve të palëve, me dt.17.07.2019, merr këtë,

AKT GJYKIM

Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, IPKO Telecommunications LLC nga Prishtina. Anullohet vendimi i të paditurit, Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, me nr.280/17 e dt.12.09.2017, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

Arsyetim

I autorizuari paditësit av.Isamedin Dedinca në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj si të bazuar dhe vendimin e të paditurit ta anuloj si të kundërligjshëm. Ka theksuar se paditësi pretendon se vendimi i të paditurit i atakuar në padi është i kundërligjshëm sepse ky vendim është nxjerr në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton se të gjithë operatorët ekonomik duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, ndërkaq i padituri me vendimin e tij jo ligjor nuk i trajton të gjithë operatorët në mënyrë të barabartë. Paditësi pretendon se vendimi i të paditurit përveç që është i kundërligjshëm është edhe në kundërshtim me vendimin e ekspertit shqyrtues, të cilin e ka angazhuar vet e paditura. Më tutje në vijim eksperti shqyrtues me mendimin dhe konstatimin e tij të dt.25.08.2017, ka konstatuar se autoriteti kontraktues Komuna e Pejës, kur ka zhvilluar procedurën e prokurimit për këtë rast, nuk ka bërë shkelje të nenit 9.4 të LPP-së, pasi që kjo dispozitë ligjore nuk parashih përjashtimin e procedurës së prokurimit dhe se përjashtimi nga zbatimi i procedurës së prokurimit publik mund të bëhet vetëm në rastin që parashihet me nenin 3 të LPP-së. Sipas ekspertit shqyrtues shërbimet e telefonisë mobile si në rastin konkret nuk parashihen si shërbime që përjashtohen në kuptim të nenit 3 të LPP-së, dhe në këtë drejtim eksperti shqyrtues i rekomandon autoritetit kontraktues, Komunës së Pejës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit. Mirëpo i padituri pavarësisht kësaj e anuloi aktivitetin dhe e obligon autoritetin kontraktues që të mos zhvilloj procedurë të prokurimit dhe të lidhë drejtpërdrejt kontratë me Telekomin e Kosovës pa procedurë të prokurimit. Paditësi pretendon se i padituri përveç se ka vendosur në kundërshtim me

Ligjin e Prokurimit Publik i padituri gabimisht ka vërtetuar edhe gjendjen faktike, sepse operatori ekonomik Telekom i Kosovës e konsideron si autoritet publik i cili në të vërtetë nuk është, sepse Telekom i Kosovës është ndërmarrje publike sipas ligjit dhe në rastin kur ofron shërbime si në rastin konkret ka cilësinë e operatorit ekonomik dhe duhet t'i nënshtrohet konkurrencës së lirë. Mirëpo i padituri në interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së dhe duke vepruar edhe në kundërshtim me ekspertin shqyrtues vendos krejtësisht në mënyrë të kundërligjshme. Paditësi pretendon se i padituri ka bërë vërtetim të gabuar të dispozitës së nenit 9.4 të LPP-së kur ka vendosur për këtë rast pasi që kjo dispozitë ligjore ka të bëjë me shërbimet apo furnizimet që mund të jenë në dispozicion nga autoriteti tjetër publik në emër të tyre, por jo për shërbimet që planifikohet të lidhen me kontrata publike me operator ekonomik siç është rasti konkret. Paditësi pretendon se i padituri ka vepruar krejtësisht në mënyrë të kundërligjshme, e kur ka anuluar aktivitetin e prokurimit publik për këtë rast dhe ka urdhëruar që të mos zhvilloj fare procedurë të prokurimit, sepse për shërbime të telefonisë mobile domosdoshmërisht çdo autoritet publik kontraktues, duhet t'i nënshtrohet konkurrencës dhe të ofroj mundësi të barabarta për të gjithë operatorët potencial, paditësi në padi në mënyrë kronologjike i ka elaboruar edhe pretendimet tjera në bazë të të cilave rezultoi në vendimin e të paditurit është jo ligjor. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj si të bazuar ndërsa vendimin e të paditurit ta anuloj si të kundërligjshëm.

I autorizuari i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë si të pabazë, dhe qëndron pas përgjigjes në padi, duke theksuar se paneli shqyrtues përmes vendimit të kontestuar ka aprovuar kërkesën e Telekomit të Kosovës dhe përmes arsyetimit i është referuar interpretimit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, rrjedhimisht për këtë procedurë do të thotë se është përjashtuar legjislacioni për prokurim publik. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.17.07.2019, ka bërë administrimin e provave që gjenden në shkresë të lëndës dhe atë: vendimi i të paditurit i dt.12.09.2017, dosja e tenderit e iniciuar nga autoriteti kontraktues, Komuna e Pejës me titull shërbimet e telefonisë mobile për nevojat e institucioneve komunale me nr.65/340/221 i dt.24.07.2017, ankesa e paditësit drejtuar të paditurit e dt.15.08.2017, vendimi i të paditurit i dt.12.09.2017, raporti mbi ekspertizën e ekspertit shqyrtues i dt.24.08.2017, vendimet e Kuvendit të Kosovës i dt.09.08.2017, dhe i dt.02.07.2019, përgjigja e lëshuar nga KRPP për drejtorin e Telekomit të Kosovës e dt.09.11.2016, si dhe parashtesa e paditësit e dt.16.07.2019.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e OSHP-së me nr.280/17 e dt.12.09.2017, është aprovuar si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Telekom i Kosovës në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të telefonisë mobile për nevojat e institucioneve komunale" me nr.prot 635/3404/221 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Pejës dhe është anuluar njoftimi për kontratë i Komunës së Pejës lidhur me aktivitetin e prokurimit titull "Shërbime të telefonisë mobile për nevojat e institucioneve komunale" me nr.prot 635/3404/221 të iniciuar nga Komuna e Pejës.

Paditësi i pakënaqur me të njëjtin vendim, me dt.15.09.2017, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, duke e kundërshtuar ligjshmërinë e tij.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla, për shkak të te cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47.2 përcaktohet se struktura dhe elementet e detyrueshmë të aktit administrativ të shkruar, ku një ndër këto elemente është se "Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin dhe mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjal. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruar një nga anëtarët e organit kolegjal". Ndërsa në nenin 48 të këtij ligji është përcaktuar se "1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij". Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërtshëm me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Në arsyetimin e vendimit, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se "Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimit dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik ka lëshuar një interpretim në lidhje me pretendimin e OE ankesës për mosrespektim të nenit 9.4 të LPP-së. Paneli shqyrtues duke pasur parasysh interpretimin e KRPP-së tek pyetjet e shpeshta me numër 36, vjen në përfundim se Telekom i Kosovës është autoritet publik dhe se autoritet kontraktues në këto raste duhet të trajtojnë dhe të veprojnë me autoritetet publike sikurse parashihet në nenin 9.4 të LPP-së dhe për këtë arsye ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet".

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se i padituri gabimisht ka vendosur duke mos respektuar nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik, Nr.04/L-042, i cili rregullon çështjen e Barazisë në Trajtim/Jo-Diskriminimi, kupërcaktohet se "1. Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. 3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoriteti kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik. 4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. 5. Autoriteti

kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit. 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse".

Po ashtu gjykata gjenë se i padituri ka vendosur edhe në kundërshtim me raportin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së, të dt.24.08.2017, i cili ekspert ka konstatuar se "Pretendimet ankomore nuk janë të qëndrueshme dhe i rekomandon Autoritetit Kontraktues të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me kërkesat e LPP pasi që neni 9.4 i LPP nuk bën përjashtim e procedurave të prokurimit dhe se shërbimet e telefonisë mobile nuk mund t'i atribuohen nëniti 3 të LPP i cili mundëson që disa autoriteti kontraktues për disa prokurime të veqanta mund t'i përjashtojnë dispozitat ligjore të LPP për realizimin e një kontrate të tillë".

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurit se "vendimi të kontestuar ka aprovuar kërkesën e Telekomit të Kosovës dhe përmes arsyetimit i është referuar interpretimit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, rrjedhimisht për këtë procedurë do të thotë se është përjashtuar legjislacioni për prokurim public", të njëjtin pretendim gjykata e vlerëson si të pa bazuar, nga fakti se i padituri nuk mundet ta bazoi vendimin në një përgjigje të KRPP-së e cila është në kundërshtim me ligjin për Prokurim Publik, e cila përgjigje ka cituar se "Si përfundim KRPP konsideron se çdo autoritet kontraktues (Autoritet Publik) në Republikën e Kosovës i cili ka nevojë për ndonjë shërbim të cilin e posedon po ashtu ndonjë autoritet tjetër publik në Republikën e Kosovës duhet të veprojë në bazë të paragrafit 4 të nenit 9 të këtij ligji". Sipas vlerësimit të kësaj gjykate Telekomit i Kosovës nuk është Autoritet Publik, por është ndërmarrje publike, në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike e cila kur ofron ofron shërbime si në rastin konkret e ka cilësinë e operatorit ekonomik, dhe në këtë kuptim duhet t'i nënshtrohet konkurrencës së lire përkatësisht Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë

aktgjykim dhe pasi t'i menjanojë të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
A.nr. 1574/2017, dt. 17.07.2019

Zyrtar Ligjor  
*Padim Gashi*



Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.